



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**



*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

**Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu  
Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety**

**Nr. 1/15**

**Datë: 13.06.2016**

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si dhe në bazë të nenit 4 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 14-të e Bordit të AKSP-së të mbajtur me datë 14.03.2016.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Lulzim Rafuna

Kryesues i Bordit

**Vendimi iu dërgohet:**

- Anëtarëve të Bordit, dhe
- Arkivit të AKSP-së



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**



*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu  
Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety

**Nr. 2/15**

**Datë: 13.06.2016**

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, nenit 4 dhe 11 të Rregullores Nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike si dhe nenit 36 të Rregullores Nr. 26/2013 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Caktohen kuotat e Institucioneve të Sigurisë Publike për vendet e studimit në studimet themelore bachelor në sigurinë publike në Akademi për vitin akademik 2016-2017.
2. Kuotat për pranim në Akademi në studimet themelore bachelor në sigurinë publike për vitin akademik 2016-2017 për zyrtarët e Institucioneve të Sigurisë Publike janë të ndara si në vijim:
  - 2.1. Policia e Kosovës 23 studentë;
  - 2.2. Dogana e Kosovës 5 studentë;
  - 2.3. Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave 11 studentë;
  - 2.4. Shërbimi Korrektues i Kosovës 23 studentë;
  - 2.5. Shërbimi Sprovues i Kosovës 1 studentë, dhe
  - 2.6. Inspektorati Policor i Kosovës 2 studentë.
3. Nëse institucioni përkatës nuk i shfrytëzon vendet sipas kuotës së përcaktuar, kuota plotësohet me studentët nga institucioni tjetër.
4. Obligohen Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe institucionet e sigurisë publike për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Lulzim Rafuna

Kryesues i Bordit

**Vendimi iu dërgohet:**

- Anëtarëve të Bordit
- AKSP, PK, DK, AME, SHKK, SHSK, IPK, dhe
- Arkivit të AKSP-së



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**



*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

**Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu  
Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety**

**Nr. 3/15**

**Datë: 13.06.2016**

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, nenit 4 dhe 11 të Rregullores Nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike si dhe nenit 36 të Rregullores Nr. 26/2013 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Grupi Punues për përcaktimin e statusit të studentëve në Agjencionet përkatëse pas përfundimit të Fakultetit të Sigurisë Publike/AKSP në këtë përbërje:
  - 1.1. Përfaqësuesi nga personeli akademik - kryesues;
  - 1.2. Kryesuesi i Këshillit të Studentëve - anëtar;
  - 1.3. Një përfaqësues nga Policia e Kosovës - anëtar;
  - 1.4. Një përfaqësues nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave - anëtar;
  - 1.5. Një përfaqësues nga Shërbimi Korrektues i Kosovës - anëtar;
  - 1.6. Një përfaqësues nga Shërbimi Sprovues i Kosovës - anëtar, dhe
  - 1.7. Një përfaqësues nga Inspektorati Policor i Kosovës - anëtar.
2. Grupi Punues ka për detyrë që pas analizimit të çështjes së statusit, t'i rekomandoj Bordit të AKSP-së opsionin i cili përfshin statusin-pozitën e studentëve në Agjencionet përkatëse pas përfundimit të Fakultetit të Sigurisë Publike/AKSP.
3. Grupi Punues varësisht prej nevojave në faza të caktuara të punës, mund të ftoj anëtar tjerë për të qenë pjesëmarrës në Grupin Punues.
4. Me qëllim të kryerjes efektive të aktivitetit të tij, Grupi Punues mund të themelojë ekupe profesionale.
5. Në punën e tij, Grupi Punues mund të shfrytëzojë mbështetjen profesionale të organizatave dhe institucioneve përkatëse vendore dhe ndërkombëtare.

6. Obligohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe Institucionet e Sigurisë Publike për sigurimin e kushteve të nevojshme për punën e Grupit Punues.
7. Obligohen institucionet nga pika 1 e këtij vendimi për caktimin e përfaqësuesve deri me datën 01.07.2016.
8. Grupi Punues obligohet të hartojë raport pune të detajuar për secilin institucion dhe të njëjtin raport së bashku me rekomandimet konkrete të dorëzon tek anëtarët e Bordit të AKSP-së përmes sekretarisë në mbledhjen e paraparë për muajin dhjetor/2016.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Lulzim Rafuna

---

Kryesues i Bordit

**Vendimi iu dërgohet:**

- Anëtarëve të Bordit
- Anëtarëve të grupit punues, dhe
- Arkivit të AKSP-së



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**



*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

**Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu  
Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety**

**Nr. 4-15**

**Datë: 13.06.2016**

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, nenit 4 dhe 11 të Rregullores Nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike si dhe nenit 58 të Rregullores Nr. 26/2013 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Lejohet mobiliteti i studentëve të institucioneve të sigurisë publike në Fakultetin e Sigurisë Publike/AKSP pa ndërprerje të pagës mujore.
2. Institucionet e sigurisë publike lirohen nga të gjitha kompenzimet dhe shpenzimet tjera që kanë të bëjnë me mobilitetin.
3. Obligohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe institucionet e sigurisë publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Lulzim Rafuna

Kryesues i Bordit

**Vendimi iu dërgohet:**

- Anëtarëve të Bordit
- AKSP, PK, DK, AME, SHKK, SHSK, IPK, dhe
- Arkivit të AKSP-së